



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

P/VENDIM

Nr. ___ datë ___ / ___ 2026

PËR VENDOSJEN E STATUJËS SË OLLGA SHURAJA NË "PANTEONIN" NË
PARKUN "SHATRËVANI"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1 shkronja "b", pika 1/1.7 shkronja "b", neni 54 shkronja "ll" dhe neni 55 pika 2 dhe 6, si dhe të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" (i ndryshuar), neni 3, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 02.07.2021 "Për krijimin e një "PANTEONI" në parkun "Shatërvani", si dhe në shqyrtim të kërkesës së Shoqatës Kulturore "Albania s'ka Problem", protokolluar me tonën me nr. 1691 prot , datë 08.05.2026 për vendosjen e bustit të znj. Ollga Shuraja në qytetin e Përmetit, Këshilli Bashkiak Përmet, me propozim të Kryetarit të Bashkisë

VENDOSI:

1. Të miratojë vendosjen e statujës së Ollga Shuraja në "PANTEONIN" në parkun "Shatërvani".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përfshirjes Sociale , Arsim-Kulture,Sporte dhe Drejtoria e Urbanistikes,Planifikimit të Territorit,Sektorit Juridik dhe Prokurimeve
3. -Ky vendim shpallet brenda 10 diteve nga data e miratimit.

KRYETARI BASHKISË
Alma HOXHA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET



RELACION

MBI VENDOSJEN E STATUJËS SË OLLGA SHURAJA NË "PANTEONIN" NË PARKUN "SHATËRVANI"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1.1 shkronja "b", pika 1/1.7 shkronja "b", neni 54 shkronja "ll" dhe neni 55 pika 2 dhe 6, si dhe të ligjit nr. 9270, datë 29.07.2004 "Për sistemin e adresave" (i ndryshuar), neni 3, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 02.07.2021 "Për krijimin e një "PANTEONI" në parkun "Shatërvani", si dhe në shqyrtim të kërkesës së Shoqatës Kulturore "Albania s'ka Problem", protokolluar me tonën me nr. 1691 prot. datë 08.05.2026 për vendosjen e bustit të znj. Ollga Shuraja në qytetin e Përmetit, Këshilli Bashkiak Përmet, me propozim të Kryetarit të Bashkisë

Objekti i propozimit

Ky propozim ka për qëllim vendosjen e bustit të znj. Ollga Shuraja në "Panteonin" e parkut "Shatrivani", si një akt nderimi dhe përjetësimi të figurës së saj në kujtesën historike dhe kulturore të qytetit të Përmetit.

Kërkesa e shoqatës

Ky propozim vjen në vijim të kërkesës zyrtare të Shoqatës Kulturore "Albania s'ka Problem", me nr. prot. ¹⁶⁹¹ datë ^{08/}2026, për vendosjen e bustit të znj. Ollga Shuraja në "Panteonin" e parkut "Shatrivani".

Shoqata ka marrë përsipër iniciativën artistike dhe kulturore për realizimin e bustit, ku konceptimi, punimi artistik dhe derdhja në bronz janë realizuar si kontribut i saj në nder të kësaj figure të shquar të qytetit të Përmetit. Kjo iniciativë është ndërmarrë nga gazetari Bledi Mane, si pjesë e angazhimit të tij në promovimin e vlerave kulturore, turistike, artistike dhe figurave historike të qytetit të Përmetit.

Shoqata shpreh gjithashtu vullnetin që ky bust të dhurohet për qytetin e Përmetit si vepër arti dhe mirënjohjeje për kontributin e znj. Ollga Shuraja në jetën kulturore, arsimore dhe shoqërore



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Kush është Ollga Shuraja

Ollga Shuraja është një nga figurat më të spikatura të qytetit të Përmetit, një personalitet që përfaqëson emancipimin shoqëror, kulturor dhe arsimor të gruas shqiptare, si dhe një shembull i rrallë përkushtimi ndaj dijes, artit dhe shërbimit publik.

E lindur në Përmet dhe e formuar në një nga institucionet më të rëndësishme arsimore të kohës, institutin “Nëna Mbretëreshë”, ajo u rrit në një periudhë historike kur roli i gruas në shoqëri ishte ende i kufizuar, por arriti të shndërrohej në një nga zërat më të hershëm të emancipimit dhe përfaqësimit kulturor të gruas shqiptare.

Një moment historik në jetën e saj dhe në historinë e artit shqiptar është pjesëmarrja e saj si gruaja e parë që interpretoi në Teatrin Kombëtar, në veprën “Topazi”, të vënë në skenë në maj të vitit 1945. Ky fakt e rendit Ollga Shurajën ndër pionieret e artit skenik shqiptar dhe ndër gratë e para që thyen barrierat e kohës në jetën kulturore të vendit.

Përveç kontributit në art, ajo ka dhënë një kontribut të gjatë dhe të vyer në fushën e arsimit. Si mësuese e përkushtuar, ajo edukoi me dashuri, disiplinë dhe profesionalizëm breza të tërë nxënësish, duke u vlerësuar me titullin e lartë “Mësuese e Merituar”. Përmes punës së saj, ajo kontribuoi drejtpërdrejt në zhvillimin arsimor dhe kulturor të komunitetit përmetar.

Ollga Shuraja ishte gjithashtu një nga vajzat e para të angazhuara në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, duke përfaqësuar një brez grash që kontribuan jo vetëm në luftë, por edhe në ndërtimin e shoqërisë së re shqiptare pas çlirimit.

Në gjithë jetën e saj, ajo mbeti e lidhur ngushtë me librin dhe dijen. Edhe në moshë të thyer, ajo ishte një lexuese e rregullt e bibliotekës së qytetit, duke u bërë një shembull i rrallë i dashurisë për kulturën dhe dijen. Kjo lidhje e fortë me librin e bën figurën e saj edhe më frymëzuese për brezat e rinj, në një kohë kur interesimi për leximin dhe kulturën shpesh është në rënie.

Për kontributin e saj të gjithanshëm në art, arsim, emancipim shoqëror dhe qytetari, znj. Ollga Shuraja është vlerësuar me titullin “Qytetar Nderi i Përmetit” me Vendim të Këshillit Bashkiak



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr.14 datë 31.01.2014 me motivacionin “Gruaja e parë që aktroi në organin më të lartë të aktrimit, Teatrin Kombëtar në Tiranë, në vitet e para pas çlirimit të vendit, një mësuese me aftësi të larta pedagogjike të kohës së vet, me nivel bashkëkohor në zhvillimin e reformave edukativo-mësimore në shkollat tona, një grua dhe person me aftësi të larta profesionale në drejtim të mësimdhënies dhe nxënies së nxënësve, një luftëtare e paepur e Luftës së Dytë Botërore.” Gjithashtu, në nder të figurës së saj, Qendra Rinore e qytetit të Përmetit mban emrin “Ollga Shuraja”, si një vlerësim institucional dhe një mënyrë për të mbajtur të gjallë kujtimin dhe kontributin e saj në jetën e qytetit

Vlerësimi dhe Propozimi

Ollga Shuraja mbetet një figurë emblematike e qytetit të Përmetit dhe një nga personalitetet që ka lënë gjurmë të thella në historinë kulturore dhe arsimore të tij. Ajo përfaqëson një model të rrallë qytetarie, ku ndërthuren arti, arsimi, emancipimi dhe përkushtimi ndaj komunitetit.

Kontributi i saj nuk kufizohet vetëm në një fushë të vetme, por shtrihet në disa dimensione të rëndësishme të jetës shoqërore. Si artiste, ajo hapi rrugë të reja për pjesëmarrjen e grave në artin skenik shqiptar. Si mësuese, ajo kontribuoi në formimin e brezave të rinj dhe në përhapjen e dijes. Si qytetare, ajo u angazhua në proceset e rëndësishme historike të kohës, duke qenë pjesë e ndryshimeve shoqërore dhe emancipimit të gruas shqiptare.

Figura e saj mbetet një burim frymëzimi për të rinjtë e sotëm, duke përcjellë mesazhin e rëndësisë së dijes, kulturës dhe përkushtimit ndaj komunitetit. Në një kohë kur vlerat tradicionale dhe lidhja me librin kanë nevojë të forcohen, Ollga Shuraja përfaqëson një model që duhet ruajtur dhe promovuar.

Vendosja e bustit të saj në “Panteonin” e parkut “Shatrivani” nuk është vetëm një akt nderimi, por një akt kujtese kolektive dhe edukimi qytetar. Ky monument do të shërbejë si simbol i identitetit kulturor të Përmetit dhe si një pikë referimi për brezat e rinj, vizitorët dhe qytetarët, duke i afruar ata më shumë me historinë dhe vlerat e qytetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

“Panteoni” i Përmetit përfaqëson vendin e figurave të pavdekshme të qytetit, dhe përfshirja e Ollga Shurajës në këtë hapësirë është një akt i natyrshëm dhe i merituar, që pasuron më tej kujtesën historike dhe kulturore të komunitetit përmetar.

Bashkëlidhur këtij relacioni paraqitet ortofoto e zonës së ndërhyrjes, ku është përcaktuar vendndodhja e saktë e bustit në “Panteonin” në parkun “Shatrivani”.

Ky projektvendim kalon për miratim, nëse nuk do të ketë sugjerime nga Komisioni i Kulturës, Arsimit, Sportit dhe Turizmit, si dhe nga anëtarët e Këshillit Bashkiak.

Konceptoi:

Specialist i Kulturës

Ledjan Komino

Pranoi:

Drejtor i Përfshirjes Sociale, Arsim-Kulturë, Sporte

Arjana Papapano





printo_20260512_0847

<https://geoportal.asig.gov.al>
Data e Printimit: 12.05.2026.

530250 006
4459550 227

530079 026
4459550 227



530079 026
4459550 227

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron ta dhena gjeonapësive të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse. Përqendrimi për saktësi të ditëve është a autoritet publik që i ka krijuar ato.

Legjenda

- Oritofoto
- 2026
- Shitëse
- Parë
- .sialt
- rrasat
- Rendi 1
- Rendi 1 (kultur)

Sistemi koordinativ: KRQJSH
Projektimi: KRQJSH
530250 006
4459550 227

2. Leoljon Kamina
Zj. Ajlona Poppo

Nr 1691 Prot
Date 08.05.2026

Tiranë më, 04.05.2026

Lënda Kërkese për vendosjen e bustit të znj. Ollga Shuraja në "Panteonin" e parkut "Shatrivani"

Drejtuar: Bashkisë Përmet dhe Këshillit Bashkiak Përmet

Shoqata kulturore "Albania s'ka problem", pjesë e Festivalit Ndërkombëtar "Vjosart", në kuadër të misionit të saj për promovimin e vlerave kulturore, historike dhe artistike, paraqet këtë kërkesë zyrtare për miratimin e vendosjes së bustit të znj. Ollga Shuraja në "Panteonin" e parkut "Shatrivani", në qytetin e Përmetit.

Koncepti, realizimi artistik dhe derdhja në bronz e këtij busti është një iniciativë e shoqatës sonë, si një kontribut i drejtpërdrejtë kulturor dhe simbolik në nder të një figure të shquar të qytetit të Përmetit dhe historisë shqiptare.

Shoqata "Albania s'ka problem", përmes këtij projekti artistik, ka synuar të përjetësojë figurën e znj. Ollga Shuraja, e cila përfaqëson një nga personalitetet më të rëndësishme të emancipimit shoqëror, kulturës dhe arsimit shqiptar, si dhe një nga gratë e para që kanë shënuar histori në artin skenik shqiptar.

Duke marrë parasysh se:

znj. Ollga Shuraja është shpallur "Qytetar Nderi i Përmetit" me vendim të Këshillit Bashkiak,

Qendra Rinore e qytetit të Përmetit mban emrin e saj,

dhe "Panteoni" në parkun "Shatrivani" është hapësira e dedikuar për figurat e shquara të qytetit,

Shoqata jonë shpreh dëshirën dhe vullnetin që ky bust të vendoset si dhuratë për qytetin e Përmetit, në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për figurën e saj.

Kërkojmë nga Bashkia Përmet / Këshilli Bashkiak:

Miratimin e vendosjes së bustit të znj. Ollga Shuraja në "Panteonin" e parkut "Shatrivani".

Përcaktimin e procedurave teknike dhe institucionale për vendosjen e tij në hapësirën përkatëse.

Shoqata "Albania s'ka problem" mbetet e angazhuar për të bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet vendore në realizimin me sukses të këtij projekti me vlerë kulturore dhe qytetare.

Me respekt,

Shoqata Kulturore "Albania s'ka Problem"

Alket Saliasi

